Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës në bazë të Marrëveshjës së Mirëkuptimit me Kolegjin Amerikan të Thessalonikit (ACT)-Greqi, të dates 17.11.2011, shpall :

KONKURS

Për ndarjën e bursave universitare për vitin akademik 2012/2013

Kolegji Amerikan iThesalonikit ACT- Greqi ofron 15 bursa për studentët nga Kosova për studime Bachelor dhe studime postdiplomike Master, duke filluar nga viti akademik 2012/2013.

VLERA E BURSAVE

Ofrohen tri bursa(3) me mbulesë të 70 % të taksave të studimit (tuition fees) për programim Bachelor. Taksa për nivelin Bachelor është 8,200.00 €. Studentët të cilët e fitojnë kë lloj burse do të paguajnë vetëm 30% të kësaj shume. Shpenzimet tjera (akomodimi, ushqimi, librat etj.) do të mbulohen nga vet studenti. Studimet për nivelin Bachelor në ACT zgjasin katër (4) vite.

Ofrohen shtatë bursa (7) bursa me mbulesë të 50 % të taksave të studimit për nivelin Bachelor. Taksa e nivelit BA është 8,200.00 €. Studentët të cilët fitojnë këtë lloj burse do të paguajnë vetëm 50 % të kësaj shume. Shpenzimet tjera (akomodimi, ushqimi, librat etj.) do të mbulohen nga vet studenti. Studimet për nivelin Bachelor në ACT zgjasin katër (4) vite.

Ofron pesë (5) bursa në mbulesë të 50% të taksave të studimit për Programin Master (MBA).Taksa e studimit për nivelin Master në ATC është 12,960.00 €. Studentët të cilët fitojnë këtë burse do të paguajnë vetëm 50% të kësaj shume. Shpenzimet tjera (akomodimi, ushqimi, librat etj.) do të mbulohen nga vet studenti. Studimet për nivelin Master në ACT zgjasin një (1) vit si program I rregullt, dhe dy (2) vite si program me korrespodencë.

VLERËSIMI I APLIKACIONEVE

Aplikacionet do të vlerësohen bazuar në:

- Kompletimin e dokumentacionit relevant
- Letrës së motivimit
- Notës Mesatare gjatë studimeve paraprake
- Rezultateve të testit në gjuhën angleze (MASHT dhe ACT do të organizojnë një test të gjuhës angleze)

Programet e Studimit të ofruara për Bursa në Kolegjin Amerikan të Thessalonikit janë:

Programet në nivelin Bachelor

Administrim Biznesi (Business Administration)

- Financa
- Biznesi Ndërkombëtar
- Menaxhment
- Marketing
- Menaxhment në Fushën e Energjisë

Teknologjia e Informacionit (Information Technology)

- Biznesi dhe Përllogaritja
- Media Elektronike
- Zhvillimi I Webit

Marrëdhëniet Ndërkombëtare

- Studime Ballkanike dhe Evropiane
- Diplomaci me Marrëdhënie Ndërkombëtare

Gjuhë Angleze

- Gjuha dhe Letërsia
- Komunikim dhe Media
-

Programet në Nivelin Master(MBA):

Administrim Biznesi

- Banka dhe Financa
- Ndërmarrësi
- Menaxhment
- Marketing

DOKUMETET E NEVOJSHME PËR PJESËMARRJE NË KONKURSIN PËR BURSA

Për Nivelin Bachelor:

1. CV (biografi)
2. Aplikacioni online për bursa mund të shkarkohet në këtë link dhe të plotësohet online: http://www.act.edu/bachelor_admission/part_i.jsp -
3. Aplikacioni për bursa i plotësuar : http://www.act.edu/misc/Financial_Aid_Application.pdf
4. Për nxënësit të cilët përfunojnë Shkollimin e Lartë duhet ti sjellin kopjet e dëftesave te viteve paraprake, kurse Diploma të bashkangjitet pas përfundimit të shkollimit. D.m.th. vërtetimi I notave të klases se 10, 11,12 dhe diploma mbas marrjes se saj.
5. Vërtetim të gjendjës financiare të të ardhurave të prindërve, për dy vitet e fundit.
6. Letër motivimi
7. Kopje të letërnjoftimit dhe pasaportës.
8. Një foto të vogël
9. Preferohet dokumentacion shtesë nëse keni ndonjë dëshmi-Çertifikatë të cilat ju ndihmojnë për fitimin e burses.

Aplikacionet plotësohen online në linqet e cekura më lartë , kurse dokumentet tjera dorëzohen nëpërmes Arhivës së Ministrisë.

Për nivelin MASTER:

1. CV (biografi)
2. Aplikacioni online për bursa mund të shkarkohet në këtë link dhe të plotësohet online: http://www.act.edu/mba_admission/part_i.jsp
3. Aplikacioni për bursa i plotësuar : http://www.act.edu/misc/Financial_Aid_Application.pdf
4. Diploma apo Certifikata e diplomimit dhe transkripta zyrtare e notave të provimeve të dhëna gjatë studimeve
5. Vërtetim të gjendjës financiare të të ardhurave të prindërve, apo të punësimit tuaj nëse jeni të punësuar për dy vitet e fundit.
6. Letër motivimi
7. Kopje të letërnjoftimit dhe pasaportës.
8. Një foto
9. 2 Letër rekomandime
10. Të gjitha dokumentet duhet të jenë të përkthyera në gjuhën angleze, gjithashtu kopjet e dëftesave duhet të jenë të vërtetuara në Komunë, dhe të përkthyera nga Përkthyes gjyqësor.
11. Preferohet dokumentacion shtesë nëse keni ndonjë dëshmi-Çertifikatë të cilat ju ndihmojnë për fitimin e burses.

Aplikacionet plotësohen online në linqet e cekura me lartë, kurse dokumentet tjera dorëzohen nëpërmes Arhivës së Ministrisë.

Aplikuesit do ti nënshtrohen testit të gjuhës angleze dhe për këtë ata do të njoftohen me kohë.

KJO VLENË VETËM PËR ATA TË CILËT DO TA FITOJNË BURSËN:

Për studentët të cilët do të fitojnë bursën do të paguajnë një shum prej 70 € (shtatëdhjetë euro) për aplikimin. Kurse pas njoftimit për fituesit e bursave, studentët do të kenë një muaj kohë për të pranuar apo refuzuar bursën. Nëse e pranojnë bursën , ata janë të detyruar të paguajnë një tarifë prej 825 € (tetëqind e njëzetë e pesë euro) si garancion, I cili natyrisht do të zbatohet duke zbritur pagesën e studimeve të cilët do ta paguajnë.

Afati I Aplikimit – nga data 17 janar 2012, dhe afati I fundit për aplikim është 20.02/2012 nga ora 09.00-16.00

Aplikacionet - mund të shkarkohen në Webfaqe të Ministrisë së Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë - http://www.masht-gov.net, apo mund t'i merrni në katin e III- zyra 302, tek Znj. Shpresa Mehmeti Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar- MASHT.

Të gjitha dokumentet e kompletuara duhet të futen në zarf të mbyllur dhe të dorëzohen në Arhivën e MASHT-kati I – rr. Agim Ramadani p.n. 10000 Prishtinë - Kosovë. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të fundit për aplikim , nuk merren ne shqyrtim

Çdo kandidat që do të konkurojë, duhet të marrë dëshmi (numër protokoli) se i ka dorëzuar dokumentet.

Dokumentacioni I dorëzuar nuk kthehet prap, pra mbetet në zyrat e Arhivës.

Për çdo informacion shtesë mund të kontaktoni :

Shpresa Mehmeti-Zyrtare në QKBNASHT- MASHT

Tel: 038 211 923 dhe emailadresa: shpresa.mehmeti@rks-gov.net